



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:252813

Datë: 18.02.2024

Numri i dokumentit: 05342939

P.nr.3142/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i çështjes Sabit Sadikaj, me bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, sipas marrëveshjes së ndërmjetësimit me numër. Nd.57/2024 të datës: 01.02.2024, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.3891/22 e datës: 23.11.2022, kundër të akuzuarit, K.C nga Prishtina, dhe L.Q nga Prishtina për shkak të veprës penale “Lëndimi i lehtë trupor ” nga neni 185, paragrafi.1, pika 1.4 të KPRK-së, jashtë seancës konform nenit 229 te KPPRK-së, dhe nenit 2 lidhur me nenin 31 të Ligjit nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), Gjykata më datë: 16.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET marrëveshja numër: Nd.57/24 të datës: 01.02.2024, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të akuzuarit K.C nga Prishtina, ne njëri ane dhe L.Q nga Prishtina në anën tjetër.
- II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.3891/212 e datës: 23.11.2022.
- III. PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarve: K.C nga Prishtina, dhe L.Q nga Prishtina për shkak të veprës penale “Lëndimi i lehtë trupor ” nga neni 185, paragrafi.1, pika 1.4 të KPRK-së Për shkak se të akuzuarit kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit.
- IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën PP.II.nr.3891/22 e datës: 29.04.2021, ka ngritur aktakuzë kundër kundër të akuzuarit, K.C nga Prishtina, dhe L.Q nga Prishtina për shkak të veprës penale “Lëndimi i lehtë trupor ” nga neni 185, paragrafi.1, pika 1.4 të KPRK-së Gjykata me datë: 01.02.2024, ka caktuar dhe mbajtur, seancën e shqyrtimit fillestar në këtë

çështje penale dhe me dakordimin e palëve në procedurë e duke vepruar konform nenit 8 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendrën për Ndërmjetësim.

Me datë 01.02.2024 në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë është arritur marrëveshja Nd.57/2024 të datës: 01.02.2024, në mes të palëve në procedurë. Andaj, gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Konform nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësimin, nga data e pranimit nga gjykata, përkatësisht nga data 16.02.2024, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 357 par.1 nënpar. 1.3 të KPPK-së lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL

P.nr.3142/22 e datës: 16.02.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Asdren Selmani

Gjyqtari,  
Sabit Sadikaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa dhe e njëjta do ta ketë Fuqinë e titullit ekzekutiv.